



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA / MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND
GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, Ligjin Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës dhe Statutin e Baletit Kombëtar të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012, për Avancim në Karrere të Nepunësve Civil, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS (Rekrutim i brendshëm)

Titulli i punës: Drejtor

Institucioni: Baleti Kombëtar i Kosovës

Kategoria funksionale / Koeficienti: 10

Numri i referencës: 24/2018

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të BKK

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Këshillit Drejtues të Baletit Kombëtar të Kosovës, përmbush detyrat e poshtëshënuara:

1. Udhëheq punën e Baletit Kombëtar të Kosovës;
2. Përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë materiale-financiare si dhe ligjshmërinë dhe afarizmin e Baletit Kombëtar të Kosovës;
3. Miraton programin vjetor të punës me pëlqimin paraprak të Këshillit Drejtues;
4. Propozon dhe nxjerr aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për shpërndarjen e pagave, të cilin e miraton Këshilli Drejtues;
5. Merr vendime në lidhje me marrëdhënien e punës së punëtorëve në pajtim me ligjin;
6. Ka të drejtë dhe detyrë të merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues dhe komisioneve e trupave të tjera, pa të drejtë vote;
7. Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse (të përhershme dhe të përkohshme), në pajtim me Ligjin;
8. Kryen edhe punë të tjera lidhur me ecurinë e punëve të Baletit Kombëtar të Kosovës, në pajtim me këto ligj dhe me akte të tjera nënligjore.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri dhe përvojë substanciale në menaxhimin e institucioneve;
2. Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
3. Shkathhtësi në caktimin e objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
4. Shkathhtësi në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose një grup punues;
5. Shkathhtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Shkolla profesionale e Baletit , diplome universitare nga ose nga fusha e artit dhe kulturës , minimum 7 vjet pervoje pune profesionale dhe 4 vite pervoje pune ne vende udheheqese.
7. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e MKRS-së dhe institucioneve të kulturës.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mandatin: Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149, Ligji Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës dhe Statuti i Baletit Kombëtar të Kosovës.

Kohëzgjatja e mandatit është 3 vjet, me të drejtë të rizgjedhjes.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 8 (tetë) ditë.

Data e mbylljes së konkurrimit: 06.06.2019

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44, Prishtinë. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211921 dhe 038 211449(apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).